

**PERMBLEDHJE E PERGJITHSHME
E
KERKESES
PER
LEJE MJEDISI TIPI B**



Per Aktivitetin:

Prodhimi i Alkoolit dhe Pijeve Alkoolike

**Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a.,
Rrashbull**

DURRES 2018

PASQYRA E LENDES

1. INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

- 1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM**
- 1.2 INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN**
- 1.3 PRONËSIA E TOKËS**

2 PËRSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT, NJËSITË E TIJ TEKNIKE DHE AKTIVITETET /VEPRIMTARITË E LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TO

2.1 TE PERGJITHSHME

3. LËNDËT E PARA DHE MATERIALET DYTËSORE, MATERIALE TË TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NË IMPIANT/INSTALIM

4. TRAJTIMI/MENAXHIMI I MATERIALEVE

- 4.1 TRAJTIMI I MATERIALEVE TË PARA, TË NDËRMJETME DHE PRODUKTEVE**
- 4.2 MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE TË LËNGSHME NË INSTALIMIN/IMPIANTIN**
- 4.3 ASGJESIMI I MBETJEVE JASHTË INSTALIMIT/IMPIANTIT**

5 SHKARKIMET

- 5.1 SHKARKIMET NË ATMOSFERË**
 - 5.1.1 NFORMACION I DETAJUAR PËR SHKARKIMET NGA PIKAT BURIMORE NË ATMOSFERË**
- 5.2 SHKARKIMET FUGITIVE DHE ATO TË MUNDSHME**
- 5.3 SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSOR**
- 5.4 SHKARKIMET NË KANALIZIME**
- 5.5 SHKARKIMET NË TOKË**
- 5.6 SHKARKIMET E ZHURMËS**
- 5.7 VIBRACIONET**
- 5.8 RREZATIMI JO-JONIZUES**
- 5.9 PËRSHKRUAJ GJENDJEN E INSTALIMIT/IMPIANTIT**
- 5.10 VLERËSIMI I NDIKIMIT NË UJËRAT SIPËRFAQËSOR**
- 5.11 VLERËSIMI I NDIKIMIT TË LËSHIMEVE/SHKARKIMEVE NË SISTEMIN E KANALIZIMEVE**
- 5.12 VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË UJËRAT NËNTOKËSOR**
- 5.13 NDOTJA E TOKËS/UJËRAVE NËNTOKËSORE**
- 5.14 NDIKIMI I ZHURMËS**

6. REDUKTIMI I SHKARKIMIT DHE SISTEMET E KONTROLLIT

7. MONITORIMI

- 7.1 MONITORIMI DHE MARRJA E MOSTRAVE**
- 7.2 MONITORIMI I CILËSISË SË MJEDISIT**

8. ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT ME TE MIRA TE DISPONUESHME

9. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

- 10. PERSHKRIMI I MASAVE TE TJERA PARANDALUESE TE PLANIFIKUARA**
- 11. PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE**
- 12. DEKLARATA**

1 INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN
1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

| | |
|--|---|
| Emri i Kompanisë | “KANTINA E PIJEVE GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU” sh.a. |
| Statusi Ligjor (Sh.P.K; SH.A, Degë, Zyrë përfaqësimi) | Aktiv |
| Ortakët/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR) | Helidon KUSHI |
| Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë | “KANTINA E PIJEVE GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU” sh.a. Lagja 14, Rruga “Bajram Tusha” Rrashbull -Durrës RRASHBULL, DURRES |
| Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mesipërme | ----- |
| Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT) | J61811527M |
| Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit” | 7.7 |
| Kodi SNAP | Nuk aplikohet |
| Kodi NOSE-P | Nuk aplikohet |
| Numri i Punonjësve | 60 |
| Përfaqësuesi/t ligjor të Kompanisë (Administratori) | Autorizuar nga administratori |
| Emri dhe Mbiemri | |
| Pozicioni në Kompani (përvecse Administrator) | |
| Telefoni | Tel:+355 52 264628 |
| Faksi | Fax:+355 52 264627 |
| E-mail | info@kantinaskenderbeu.al HTTP://WWW.KANTINASKENDERBEU.AL |

1.2 INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

| | | | | | |
|--|---|-----------|---|---|---|
| Titulli i instalimit/impianitit | <i>“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to” – 7.7/h. “Prodhimi i alkoolit dhe pijeve alkoolike, duke perfshire fabrikat e birres”</i> | | | | |
| Adresa së ku është pozicionuar ose do të pozicionohet impianti | Rrashbull, Durres | | | | |
| Koordinatat e vendit sipas Sistemit të Koordinimit UTM | Pika | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | X | 41.330234 | | | |
| | Y | 19.497361 | | | |
| Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ⁴ (Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.) | <i>“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to”</i> | | | | |
| Kapaciteti i projektuar | 3000 litra/dite | | | | |

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, licensave dhe/ose Autorizimeve të përfutuara në datën e dorëzimit të Formularit të kërkesës.

| Leja Licensa, Autorizimi | Nr. Ref. | Data e Lëshimit | Periudha e vlefshmërisë |
|--|----------|-----------------|-------------------------|
| Leje profesionale (Ministris e Bujqesise dhe Ushqimit) | 4697 | 29 Shkurt, 2012 | Pa afat |

Duhet të përfshihen të gjitha lejet, Licensat, autorizimet të vlefshme në datën e dorëzimit të Kërkesës.

1.3. APLIKIMI I BËRË PËR:

- Impiant dhe/ose Instalim i ri
- Impiant dhe/ose instalim ekzistues
- Ndryshime të propozuara/ thelbësore në një Impiant dhe/ose instalim ekzistues

2. PËRSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT, NJËSITË E TIJ TEKNIKE DHE AKTIVITETET /VEPRIMTARITË E LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TO

2.1 Te Pergjithshme

Aktiviteti i shoqerise eshte prodhimi i veres dhe i pijeve te forta alkoolike, bazuar ne Shtojcen 1, te Ligjit "Per Lejet e Mjedisit" "Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to" – 7.7/h. "Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike, duke perfshire fabrikat e birres". Ky aktivitet zhvillohet ne kantinen e pijeve "GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" sh.a., Rrashbull, Durres.

Te dhenat e truallit jepen si me poshte :

ZRPP Durres, Toke truall, Zona Kadastrale 3215, Certificate Pronesie Nr1175949 date 6.3.2017, Nr.Pasurise: 62.3 Vol.9 Fq.193, Siperfaqe Totale e Prones : 35081 m²

Kantina e Pijeve "GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" sh.a. paraqitet grafikisht ne planimetrine e saj te aprovuar nga instancat perkatese shteterore qe nga krijimi i saj. Objekti ka filluar veprimtarine si kantine pijesh ne vitin 1952 dhe, ndertimi i pjeses se re (godina aktuale) ka perfunduar se ndertuari ne vitin 1988, e aprovuar nga instancat shteterore te kohes. Ajo ndodhet ne Kodren e Rrashbullit ne kuoten 33 m mbi nivelin e detit. Siperfaqja vetem e objekteve te Kantines Rrashbull eshte 3960 m² dhe, shtrihet ne nje territor prej 35081 m².

Ajo ndodhet ne anen e djathte te rruges automobilistike nacionale Durres-Shijak, rreth 200 m mbi kodren e Rrashbullit.

Kantina Rrashbullit merret me trajtimin e veres, prodhimin e alkoolit rrushit nga distilimi i veres, amballazhimin e veres dhe pijeve te forta alkoolike.

Ajo ka filluar veprimtarine si kantine pijesh ne vitin 1952. Ndertimi i pjeses se re (aktuale) te saj ka perfunduar ne vitin 1988, aprovuar dhe miratuar nga instancat shteterore te kohes. Sot, ajo vazhdon aktivitetin e saj per prodhimin e veres dhe pijeve te forta alkoolike.

Terreni ku shtrihet kantina eshte koder argjilore dominuese me zonen e afert me ate. Vendi ku eshte vendosur ajo, ka erera te vazhdueshme dhe ajri eshte i paster, nuk ka ujra nentokesore dhe, nuk ndodhet prane nje zone arkeologjike.

Afer Kantines Rrashbull, rreth 200 m me poshte (drejtimi nga perendimi), kalon kolektori kryesor i ujrave, i cili mbledh te gjitha derdhjet e ujrave te zones.

Objektet jane te rrethuara pjeserisht me mur rrethues dekorativ dhe pjeserisht me kanxhella metalike. Rreth e perqark perimetrit te rrethimit dhe ne zonat e lira qe zene rreth 0.4 ha siperfaqe e gjelberuar, jane mbjelle shume peme frutore, dekorative dhe dhjetra drure halore bredha.

"Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a., pervec Kantines Rrashbull per te cilen po flasim, zoteron dhe Kantinen e Veres ne Sukth dhe, Vreshtat ne Kodrat Arapaj qe ndodhen rreth 7 km larg nga qyteti i Durresit.

Te dy keto objekte jane hallka komplementare te saj, te cilat plotesojne zinxhirin e prodhimit nga lenda e pare qe eshte rrushi, perpunimi e tij dhe vinifikimi, trajtimi i metejshem i veres, prodhimi i pijeve alkoolike dhe, deri ne amballazhimin e vererave dhe pijeve te forta alkoolike.

Kantina e veres ne Sukth ndodhet afersisht rreth 10 km nga qyteti i Durresit, e cila eshte pajisur me leje mjedisore te vecante.

Vreshtat e Kantines se Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a., Rrashbull, ndodhen ne kodrat e Arapaj, rreth 7 km nga qyteti i Durresit. Ato mbulojne nje siperfaqe prej 40 ha ne te cilat jane kultivuar varietetet e rrushit te bardhe dhe te kuq si *Chardonnay*, *Primitivo*, *Monte Pulciano*,

Sangiovese, Cabernet Sauvignon, Merlot dhe Negro Amaro. Pikerisht, keto varietete te rrushit jane lenda e pare ne prodhimin e veres te cilesise se larte per te cilen shquhet kantina jone

Lendet e para qe perdor Kantina jone eshte vera e prodhuar ne Sukth nga rrushi i vreshtave te saj ne Kodrat e Arapaj, alkoolin e rrushit dhe alkoolin ushqimor. Perpunimi i rrushit e prodhimi i vererave realizohet sipas teknologjise bashkekohore dhe ambalazhohet ne shishe qelqi 0.75 litra dhe konfeksione te tjera 2, 3 dhe 5 liter.

Prodhimi i rakise se rrushit dhe i alkoolit te rrushit per pijet e tjera te forta alkoolike, behet nga distilimi i veres se rrushit ne repartin e distilimit te alkoolit.

Objektet kryesore te Kantines Rrashbull jane:

- 1.- Reparti i Amballazhimit te Pijeve Alkoolike.
- 2.- Bodrumi (Perpunimi dhe Stazhionimi i Veres dhe Alkoolit Rrushit)
- 3.- Reparti i Distilimit
- 4.- Repartet Ndhimese ku perfshihen :
 - 4.1.- Reparti i Kaldajes
 - 4.2.- Oficina Mekanike dhe ambiente ndihmese
- 5.- Magaziana e Materialeve te Pergjithshme.
- 6.- Magazina e Amballazheve
- 7.- Ndertesa e Administrates dhe Laboratori.

Nje pershkrim i shkurter i aktivitetit :

“Kantina e pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu” sh.a. Rrashbull-Durres, eshte nje nga ndermarrjet me te vjetra ne Shqiperi dhe te specializuara ne prodhimin dhe tregetin e produkteve te veres dhe te pijeve te forta alkoolike.

Produktet e saj tregetohe si brenda vendit dhe ne eksport ne Europe e USA.

Linja e amballazhimit ka nje kapacitet prodhues prej 3000 litra ne dite.

Lendet ndihmese per trajtimin dhe amballazhimin e veres dhe pijeve te forta alkoolike jane lendet enologjike per trajtimin e veres (te prodhuara dhe te marra nga vendet e BE-se) si dhe shishe qelqi, tapa, etiketa, kapsula plastike e alumini, arka kartoni per amabalazhim pijesh si dhe kartona filtrimi te pijeve. Ato pranohen konform standardeve shteterore ne fuqi.

Infrastruktura inxhinerike e Kantines Rrashbull eshte e lidhur me rrjetet e furnizimit me energji elektrike dhe uje te pijshem me ato te zones ne qytetin e Durresit. Po ashtu sistemi i kanalizimeve te ujrave te zeza lidhen me ato te zonen. Ndersa objektet ndodhen direkt ne ane te rruges vjeter automobilistike nacionale Durres-Shijak.

Prodhimi i vererave realizohet sipas teknologjise bashkekohore. Ne kemi disa lloje te vecanta vererash si *Chardonnay, Primitivo, Shesh i Zi, Cabernet Sauvignon, Merlot, Riesling dhe Shesh i Bardhe* dhe ambalazhohet ne shishe 0.75 liter dhe konfeksione 2,3 dhe 5 litra.

Prodhimi i alkoolit dhe rakise se rrushit behet nga distilimi i veres te prodhuar ne sezonin e perpunimit te rrushit ne repartin e distilimit.

Konjaku “SKENDERBEU”, konjaku “BATO” dhe pijet e tjera te forta alkoolike te stazhionuara, ambalazhohen ne repartin e konservimit te pijeve alkoolike.

Uji teknologjik per pijet eshte i zbutur dhe kjo relizohet nepermjet kalimit te ujit te pijshem ne kolonen jonokembyses.

Ne cdo repart te kantines gjenden depozita uji te pijshem nga 50, 75 dhe 200 hektolitra (ose 5, 7.5 dhe 20 m³).

“Kantina e pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu” sh.a. Rrashbull, ka te punesuar rreth 60 punonjes te siguruar me sigurim shoqeror dhe shendetesor. Punonjesit jane nje nderthurje e eksperiences me mbi 25 vite pune dhe brezit te ri te sapodiplomuar. Mosha mesatare e tyre arrin ne 35 vjec. Punonjesit jane te kontraktuar ne kontrata individuale 1 vjecare.

Aktiviteti i punes kryhet ne nje turn dhe ne baze te ngarkesave sezonale kryet me 2 turne.

Perpunimi i vererave te sapo fermentuarate cilat vijne nga Kantina e Sukthit ku, gjate sezonit mund te perpunohen rreth 600-650 ton rrush, behet ne bodrumin e kantines Rrashbull. Bodrumi eshte i pajisur me dekantues i cili nuk lejon kalimin e llumrave ne sistemin e kanalizimeve te ujrave te shkarkimit.

Ne repartet e Kantines Rrashbull perdoret uji i pijshem per larje dhe shplarje te pajisjeve dhe instalimeve. Si agent lares perdoret sode kaustike 2%. Ujrat e larjes kalojne ne procese hollimi, dekantimi e precipitimi te lendeve pezull perpara se te kalojne ne kanalim kryesor te shkarkimit te kantines.

Ujrat e perdorura industriale nuk shkarkohen cdo dite te muajit. Ato kane nje frekuence sipas diteve te punes kur levizen lengjet dhe kur ka ambalazhim te pijeve alkoolike ne linjen e ambalazhimit.

Larjet e vaskave, te linjave dhe makinerive te vecanta konsumojne rreth 250 m³ uje te pijshem ne sezon ose p.sh. rreth 970 m³ per periudhen 2017-2018.

Mbetjet e perpunimit te rrushit dhe te veres qe rezultojne gjate vinifikimit kalojne per kavaletim si pleh organik ne vreshtat e kantines ne Kodrat e Arapaj. Ato jane subject trajtimi ne Kantinen e Sukthit.

Mbetjete ngurta ne Kantinen e Rashbullit jane mbetjet e letres, plastikes, shishe qelqi jashte perdorimit dhe, mbetje te tjera te natyres urbane te cilat dalin gjate aktivitetit fizik e jetesor te punonjesve.

- Mbetjet e letres dhe kartonit p.sh. per periudhen 6-mujore te kaluar qe rezultojne nga ambalazhet, jane rreth 2699 kg. Ato jane seleksionuar dhe larguar nga kompania jone per riciklim tek shoqeria EDIPAC Durres.

- Mbetjet e plasmasit qe rezultojne nga ambalazhet dhe etj. seleksionohen vecas dhe rezultojne p.sh. per te gjithë vitin 2017 ne sasite rreth 1210 kg gjithsej. Ato jane blere e evaduar vecas nga individe qe merren me grumbullimin e plastikes se riciklueshme.

- Mbetjet e natyres urbane mblidhen vecas ne 4 konteinere tip per plehrat urbane te vendosur pas fabrikes e ambalazhimit.

Sasia e tyre mesatarisht eshte 10÷12 kg ne dite, ose 288 kg ne muaj dhe, ato largohen nje here ne 4÷5 dite sipas rastit nga individe dhe kompani qe transportojne mbetje urbane per ne Sheshin e Mbetjeve Urbane te qytetit te Durresit qe ndodhet ne zonen e Spitalles ne Porto Romano.

3. LËNDËT E PARA DHE MATERIALET DYTËSORE, MATERIALE TË TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NË IMPIANT/INSTALIM

Lenda e pare kryesore per Kantinen Rrashbull eshte vera dhe materiali per distilim qe vijne nga Kantina e Sukthit e cila, eshte pjese perberese teknologjike e “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu”sh.a.

Per prodhimin e veres kuqe, veres te bardhe dhe rakise, perdoret rrush i prodhuar ne rreth 40 ha vreshta te kantines ne Kodrat e Arapaj, Durres.

Prodhimi i veres mesatarisht shkon 3900 – 4000 hektoliter ne sezon.

Vera ambalazhohen kryesisht ne shishe qelqi 0.75 l dhe ne kuti 2, 3 dhe 5 liter.

Ndersa pijet alkoolike ambalazhohen vetem ne shishe qelqi ne formate te ndryshme.

4 TRAJTIMI/MENAXHIMI I MATERIALEVE

4.1 TRAJTIMI I MATERIALEVE TË PARA, TË NDËRMJETME DHE PRODUKTEVE

Lenda e pare qe eshte vera e sapo fermentuar, vjen me autocisterne nga Kantina Sukth dhe shkarkohet ne vaskat e Bodrumit te Kantines Rrashbull. Ne bodrum vera trajtohet per stabilizim dhe staxhionim dhe, sipas nevojave te prodhimit nxirret per ambalazhim ne repartin e ambalazhimit te pijeve.

4.2 MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE TË LËNGSHME NË INSTALIMIN/IMPIANTIN

4.3 ASGJESIMI I MBETJEVE JASHTË INSTALIMIT/IMPIANTIT

Gjate zhvillimit te aktivitetit gjenerohen mbetje te ngurta te natyres urbane te cilat ne i seleksionojme veças ne tre kategori cdo moment qe rezultojnë nga proceset e punes.

Mbetjet e letres grumbullohen ne magazinën e materialeve ndihmese dhe sapo plotësohet nje ngarkese largohen nga kompania jone per riciklim letre ne nje kompani ne Durres.

Mbetjet e plastike grumbullohen po ne magazinën e materialeve ndihmese dhe largohen nga individë private qe merren me riciklimin e materialeve plastike.

Mbetjet e natyres urbane grumbullohen ne 4 konteinere teknologjike plehrash dhe evadohen nga nje kompani lokale e shërbimit te pastrimit te qytetit te Durresit. Ato trajtohen ne Sheshin e Mbetjeve Urbane te Bashkise Durres ne zonen e Spitalle Durres.

Ne paguajme te trete per keto sherbime

5 SHKARKIMET

5.1 SHKARKIMET NË ATMOSFERË

Te dhenat e shkarkimeve ne ajer jepen bashkangjitur ne raportin e vetemonitorimit mjedisor i kryer nga nje laborator referent i certifikuar.

Sipas këtij raporti, parametrat e ajrit ne zonen e afert me objektet e kantines, te matura ne 4 pika monitorimi, rezultojnë brenda kufijve te përcaktuar prej VKM Nr.803, dt.4.12.2003 “Per Miratimin e Normave te Cilesise Ajrit ne Republiken e Shqiperise” dhe Udhezimit Nr.510, dt.13.12.2011 “Per inspektimet Higjeno-Sanitare – Ministria e Shendetesise”.

5.2 SHKARKIMET FUGITIVE DHE ATO TË MUNDSHME

Nuk kemi shkarkime fluturuese

5.3 SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSOR

Nuk ka shkarkime ne ujrat siperfaqesore

5.4 SHKARKIMET NË KANALIZIME

Shkarkimet e lengeta qe rezultojnë nga aktiviteti i Kantines Rrashbull, pasi kalojne neper proceset e hollimit, dekantimit te lendeve pezull dhe precipitimit, derdhen ne kanal in kryesor te grumbullimit te ujrave te te zones.

Analizat e shkarkimeve te lengeta te Kantines Rrashbull ne kanal in kryesor te ujrave te zones, jane paraqitur ne bashkangjitur ne Raportin e Vetemonitorimit Mjedisor.

Sipas këtij raporti, parametrat e shkarkimeve te lengeta, te matura ne kanal in grumbullues te kantines ne dalje, rezultojnë brenda normave te lejuara sipas VKM Nr.177, dt.4.12.2003 “Per Miratimin e Normave e Lejuara te Shkarkimeve te lengeta dhe Kriteret e Zonimit te Mjediseve Ujore Pritese”.

5.5 SHKARKIMET NË TOKË

Nuk kemi shkarkime ne toke.

5.6 SHKARKIMET E ZHURMËS

Te dhenat e nivelit te zhurmave ne ambientet e brendshme dhe ne zonen e afert me objektet e kantines, jepen bashkangjitur ne raportin e vetemonitorimit mjedisor i kryer nga nje laborator referent i certifikuar.

Sipas këtij raporti, nivelet e ndotjes akustike ne zonen e afert me objektet e kantines, te matura ne 4 pika monitorimi, rezultojnë brenda kufijve te lejuar te LAeq mesatar = 65.1 dB (norma lejuar 70 dB) dhe LAFmax = 81.1 dB (norma lejuar 110 dB) sipas Udhezimit Nr.8, dt.27.11.2007 “Per Nivelet Kufi te Zhurmave ne Mjedise te Caktuara”.

5.7 VIBRACIONET

Nuk kemi vibracione.

5.8 RREZATIMI JO-JONIZUES

Nuk kemi rrezatime jonizuese

5.9 PËRSHKRUAJ GJENDJEN E INSTALIMIT/IMPIANTIT

“Kantina e Pijeve GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU”sh.a. sic thame edhe me lart, eshte nje aktivitet ekzistues.

Ajo eshte objekt i privatizuar.

Theksojme se “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu”sh.a. Rrashbull, eshte nje aktivitet ekzistues i cili ka qene e vleresuar per ndikimin ne mjedis dhe e pajisur me Leje Mjedisore te Tipit B me nr.identifikues 783, dt.25.09.2012 duke u klasifikuar si aktivitet i kategorise ID: 7.7/h “Per prodhimin e alkoolit dhe pijeve alkoolike duke perfshire edhe fabrikat e birres”.

Sot, aktiviteti yne paraqitet sipas per rifreskim te lejes mjedisore sipas kerkeses se AGJENSISE KOMBETARE TE MJEDIST.

Terreni ku shtrihet kantina eshte koder argjilore dominuese me zonen e afert me ate. Vendi ku eshte vendosur ajo, ka erera te vazhdueshme dhe ajri eshte i paster, nuk ka ujra nentokesore dhe, nuk ndodhet prane nje zone arkeologjike. Si rezultat, tterritori ne studim, nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si

- rezerve strikte natyrore
- rezervat shkencor
- park kombetar (Kategoria II)
- monument natyror (Kategoria III)
- rezervat natyror i menaxhuar
- zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria IV)
- pejsazh i mbrojtur
- zone muzeale apo arkeologjike.

Afer Kantines Rrashbull, rreth 200 m me poshte (drejtimi nga perendimi), kalon kolektori kryesor i ujrave, i cili mbledh te gjitha derdhjet e ujrave te zones duke perfshire edhe shkarkimet e ujrave te Kantines Rrashbull.

Klima eshte ajo e rajonit mesdhetar fushore qendrore me karakteristika klimaterike te rajonit te Shqiperise perendimore. Zona dallohet per dimera te bute mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit behet e ndjeshme.

Mjedisi biologjik i zones se afert, perfaqesohet ne afersi nga pisha te buta dhe siperfaqe rurale te lira dhe me kultura bujqesore. Ndersa brenda territorit te Kantines Rrashbull (sip.truall), eshte mbareshtuar nje siperfaqe e gjelber prej 0.4 ha e mbelle me peme frutore te ndryshme, bime dekorative dhe drure halore si bredhi, etj.

Fauna e zones eshte e lidhur ngushte me mjedisin rrethues i cili i perket natyres urbane pothuajse te nje qyteti bregdetar. Ajo perfaqesohet nga zogjte si harabela dhe pellumbat e bute, etj. Nuk gjenden gjitare e specie te tjera te egra.

Objektet jane te rrethuara pjeserisht me mur rrethues dekorativ dhe pjeserisht me kanxhella metalike.

5.10 VLERËSIMI I NDIKIMIT NË UJËRAT SIPËRFAQËSOR

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi cenim te ujrave siperfaqesore.

5.11 VLERËSIMI I NDIKIMIT TË LËSHIMEVE/SHKARKIMEVE NË SISTEMIN E KANALIZIMEVE

Ujrat e përdorura te Kantines Rrashbull mblidhen nga te gjitha objektet dhe repartet ne nje kolektor kryesor ku, ky i fundit derdhet ne Ujembledhesin Kryesor te Ujrave te zones qe kalon rreth 200 m poshte kantines nga ana perendimore. Per kete qellim, eshte ndertuar komplet i ri nje rrjet kanalizimesh nentokesore ne te gjithe territorin e kantines.

Duam te theksojme se shkarkimet e lengeta qe rezultojnë nga aktiviteti i Kantines Rrashbull, monitorohen rregullisht nga stafi teknik dhe, periodikisht kryhen matje analitike monitoruese te cilesise ujrave nga laboratore te certifikuar dhe akredituar. Sasite e ketyre shkarkimeve te lengeta nuk jane te medha, ose arrijne mesatarisht $1 \text{ m}^3/\text{dite}$ dhe ne raste te punes intensive sezonale qe mund te zgjasi disa dite mund te arrijne $2-3 \text{ m}^3/\text{dite}$.

Analizat kimike te matjeve te shkarkimeve te lengeta, kane rezultuar historikisht brenda normave te lejuara sipas VKM Nr.177, dt.4.12.2003 "Per Miratimin e Normave e Lejuara te Shkarkimeve te lengeta dhe Kriteret e Zonimit te Mjediseve Ujore Pritese".

5.12 VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË UJËRAT NËNTOKËSOR

Nuk kemi shkarkime ne ujrat nentokesore.

5.13 NDOTJA E TOKËS/UJËRAVE NËNTOKËSORE

Nuk kemi ndotje te tokes dhe ujrave nentokesore si rezultat i aktivitetit tone.

5.14 NDIKIMI I ZHURMËS

Niveli i zhurmes ne ambientet e brendshme dhe te jashtme te Kantines Rrashbull, eshte brenda kufijeve te lejuar te LAeq mes. dhe LAF max.

Te dhenat jane dhene bashkangjitur tek raporti i vetemonitorimit mjedisor.

6 REDUKTIMI I SHKARKIMIT DHE SISTEMET E KONTROLLIT

Ky instalim gjeneron nje sasi te vogel mbetjesh gjate fazes se funksionimit. Te gjitha llojet e mbetjeve te ngurta, te lengeta dhe te gazta, menaxhohen ne vazhdimesi nga stafi teknik. Ne veçanti, kujdes i shtuar tregohet ne kohe sezoni te përpunimit te veres. Ne kete rast, i gjithë stafi teknik dhe punonjësit, jane te mobilizuar maksimalisht per kryerjen detyrave te përpunimit dhe prodhimit te produkteve.

Per kete qellim jane te angazhuar te gjithë punonjësit deri ne fund te proceseve kur nevojitet largimi i mbetjeve, pastrimi i vendit te punes, larja e vaskave dhe makinerive te linjave.

Ujrat e larjes perfundojne direkt ne kanalizime nepermjet drenazhimeve qe ka cdo ambient ose makineri prodhimi. Ketu nuk rezultojnë mbetje organike ne sasi te matshme ose, le te themi se jane te papërfillshme.

Ndersa mbetjet e ngurta rezultojnë ne sasine me te madhe ne ditet kur funksionon reparti i ambalazhimit te produkteve te gatshme. Direkt pas cdo njesie prodhimi (palette ose parti prodhimi), mblidhen mbetjet e letres dhe te plastikes.

Mbetjet e ngurta te natyres urbane grumbullohen ne kosha te veçante plastike te cilet jane vendosur ne cdo zyre dhe ambient pune. Ato pastrohen cdo dite nga nje punonjës i veçante pastrimi i cili i dergon ne konteineret e plehrave prapa godines kryesore te kantines.

Shkarkimet e gazta rezultojnë brenda normave te lejuara per shkarkimet ne ajer ne Republiken e Shqiperise. Edhe ketu duhet theksuar se shkarkimet e gazta mund te rezultojnë ne dite te veçanta d.m.th. nuk ka cdo dite, edhe ato jane sezonale.

Ndotja akustike rezulton brenda normave te lejuara ku, edhe per kete tip ndotjeje vlen te nenvizojme se zhurmat emetohen vetem kur vihen ne pune makineri dhe linja te veçanta prodhimi. Funksionimi i tyre ka natyre sezonale, prandaj edhe emetimet e zhurmave jane periodike te shperndara ne dite dhe muaj te caktuar te vitit.

Pergjithesisht, mund te themi se per nivelet e shkarkimeve te tipeve te ndryshme te mbetjeve per te cilat folem ketu, jane tipike per kantinat e veres dhe rezervat per reduktimin e tyre jane ne limitet e tyre. Sepse, ato jane te lidhura me sasine e lendeve te para dhe kapacitetet e përpunimit, me sasine e ambalazheve qe përdorim, sasite e ujit dhe energjise qe konsumojme si dhe numrin e punonjësve qe kemi.

7 MONITORIMI

7.1 MONITORIMI DHE MARRJA E MOSTRAVE

Marrja e mostrave per analizat e ajrit perrreth dhe te zhurmes jane marre ne 4 pika.

Ndersa per ujrat e shkarkimeve ne kanalizime eshte marre nje moster perfaqesuese ne kolektorin kryesor te kantines, para daljes ne kanalizimin e zones.

7.2 MONITORIMI I CILËSISË SË MJEDISIT

Monitorimi mjedisor i aktivitetit te Kantines Rrashbull behet me kerkesen e DRM te Qarkut Durres dhe ne perputhje me aktet ligjore per mbojtjen e mjedisit. Ai eshte kryer nga nje institucion i pavarur, i certifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit.

Monitorimi mjedisor behet per arsye te matjes se nivelit te shkarkimeve te ndryshme ne mjedisin e zones per rreth, identifikimit te elementeve te rinj te mundshem te veprimtarise tone qe mund te ndikojne ne elementet mjedisore te zones.

Monitorimi i mjedisit realizohet me matje nepermjet metodave analitike standarte per cilesine e e ajrit ne parametrat baze, te nivelit zhurmave dhe dhe te cilesise ujrave te shkarkuara ne kanalizime.

Monitorimi i mjedisit është paraqitur i dokumentuar në Raportin e Vetmonitorimit Mjedisor periodik, i cili kohët e fundit është kryer më 17.03.2018.

Vendodhja e objektit të monitoruar ndodhet në koordinatat gjeografike:

Kodra Rrashbull - Durres, N41.330234 E19.497361

Matjet për cilësinë e ajrit dhe të zhurmave janë kryer në 4 pika të vecanta brenda territorit të instalimit. Ndërsa matjet e cilësisë ujërave të shkarkuara në kanalizime janë kryer në kolektorin kryesor të drenazhimit të ujërave, në dalje të tij.

Matjet janë kryer në mënyrë të përgjithshme, pa reshje shiu.

8 ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

Ndikimet në popullsi

Nga zhvillimi i aktivitetit të Kantines Rrashbull nuk ka ndikime negative mjedisore dhe sociale. Përkundrazi, në këto aktivitete janë përdorur direkt rreth 60 punonjës dhe indirekt shumë më tepër të cilët lidhen me aktivitetet e prodhimit të lendeve të para dhe tregtimin e produkteve.

Ndikimet në mjedis të Kantines Rrashbull si një n/jë e privatizuar me objekte ekzistuese, së pari janë përmirësuar të pandryshueshme ndër vite për shkak të kapaciteteve të përpunimit të lendeve të para të trashme të ngritura. Dhe, së dyti, nivelet e shkarkimeve të mbetjeve në mjedis jo vetëm nuk janë rritur por, mund të jenë reduktuar në sasi të konsiderueshme për shkak të përdorimit të teknologjive të reja për përpunimin e verës dhe ambalazhimit të produkteve.

Nivelet e shkarkimeve të gazta, të lengeta, i mbetjeve të ngurta dhe zhurmat, kanë rezultuar në matjet e vetëmonitorimit mjedisor brenda normave përkatëse të miratuara në Republikën e Shqipërisë.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bëhet sipas menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta. Kështu, ato grumbullohen brenda ambienteve të punës të seleksionuara sipas kategorive dhe grumbullohen në pika të veçanta nga ku, me pas, mbetjet e riciklueshme largohen për në pikat e riciklimit dhe, mbetjet e ngurta urbane grumbullohen në konteinere teknologjike dhe largohen me automjetet teknologjike të kompanive të pastrimit të qytetit.

Nuk ka ndikime negative në tokë, në ujë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Tëpër, llojet dhe sasi të shkarkimeve janë të natyrës urbane dhe nuk përbejnë rrezik shtesë për sa u përshkrua më lart në elementet e veçanta të cilësisë mjedisore.

9 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Programi i përmirësimit të instalimeve dhe ambienteve të punës po zbatohet në gjithë këto vite dhe konsiston si vijon:

- Janë përmirësuar linjat teknologjike të përpunimit të verës dhe ambalazhimit të saj duke kryer zëvendësime në pjesë këmbimi, tubacione dhe linjat e transferimit të lengjeve. Por, me të rëndësishmja është se makineritë e punës si pompa, linja mbushëse, etj. janë zëvendësuar me makineri plotësisht të reja.
- Trajtimi i verës sipas teknologjisë së përparuar bashkohore, ka ndryshuar në mënyrë rëndësore se pari cilësinë e verës si dhe shkarkimet e mbetjeve të ndryshme.

- rrjeti i drenazhimit te ujrave te përdorura industriale dhe komunale eshte rindërtuar komplet i ri. Se fundi përfundoi si investim i ri kolektori kryesor brenda territorit te kantines i cili ben te mundur qe ujrata te dalin vetem nga nje dalje nga territori kantines.
- Ne zbatim te gërmes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766, dt.05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga Zjarri", jane marre masat e nevojshme per mbrojtjen nga zjarri duke investuar per rrjetin e hidranteve dhe fikese zjarri te veçanta per cdo vend te veçante pune te parashikuar per rrezik te mundshem zjarri. Keshtu, jane vendosur fikse zjarri me kapacitet 50 kg me pluhur fosil ose me gaz karbonik sipas kerkeses teknike te vendit te punes.
- Ne cdo repart pune jane vendosur depozita uji me volume te konsiderueshme dhe jane te lidhura me instalime aktive per cdo rast nevoje.
- Personeli teknik i nënshtrohet nje trajnimi periodik per sigurimin teknik ne pune dhe rregullave te mbrojtjes nga zjarri.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Nga viti ne vit eshte investuar per permiresimin e teknikes dhe teknologjise ne pune. Rezultatet jane te dukshme se pari ne eliminimin e derdhjeve te mundshme te lengjeve ne proces, te zvogëlimit te shkarkimeve te tjera te lengeta dhe te gazta dhe te menaxhimit te integruar te mbetjeve te ngurta sipas kerkeses bashkekohore per trajtimin e tyre.

Kujdesi i veçante per ecurine e proceseve teknologjike, monitorimi i tyre i vazhdueshem nga stafi teknik dhe monitorimi mjedisor prodhimit te mbetjeve, ka permiresuar dukshem aktivitetin e kantines ne përputhje me teknika te mira te prodhimit dhe sipas akteve ligjore te mbrojtjes mjedisit.

Permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes, planifikimi i zerave financiar per trajtimin e integruar te mbetjeve te ngurta, kujdesi i vazhdueshem per uljen e konsumit te panevojshem te ujit dhe energjise elektrike, mirembajtja e sipërfaqes se gjelbëruar, kane permiresuar funksionimin e aktivitetit dhe rritur eficencen dhe performacen e kantines.

10 PËRSHKRIMI I MASAVE TË TJERA PARANDALUESE TË PLANIFIKUARA

- Te merren masa per te parandaluar renien e zjarrit dhe te sigurohen mjetet e nevojshme te ndërhyrjes ne rast te renies se zjarrit (depozite uji, zjarrfikëse portative, etj.)
- Te mirëmbahet sipërfaqja e gjelbëruar
- Te mbahet ne gadishmeri te plote sistemi i furnizimit me uje te pijshem
- Te mbahet ne gadishmeri te plote sistemi i grumbullimit dhe largimit te mbetjeve te ngurta
- Mbetjet e ngurta gjate ushtrimit te aktivitetit, do te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga pushteti vendor
- Te mbahet ne gadishmeri te plote sistemi i ventilim-aspirimit me qellim largimin e aromave te renda dhe krijimin e kushteve normale te punes ne mjediset e brendshme
- Te mbahet nen kontroll ndotja e ajrit brenda niveleve te lejuara $90 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ajer per pluhurin total (LGS) dhe $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ajer per pluhurin e frymëmarrjes (PM10)
- Te behen analizat e ujrave qe shkarkohen ne kanalizimet e zones ne nje laborator te akredituar
- Te mbahet nje rregjister periodik mbi shkarkimet dhe rezultatet e analizave
- Te mbahet kontakt me Drejtorine Rajonale te Mjedisit (DRM) ne menyre periodike duke dorëzuar prane saj raportet e monitorimit.

11 PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Ky impiant prodhon nje sasi te vogel mbetjesh gjate fazes se funksionimit.

Aktiviteti ne Kantine Rrashbull gjeneron shkarkime te ndryshme ne nje mase tipike per teknologjine e kantineve. Me kete duam te theksojme se puna nje kantine vere ka natyre sezonale dhe si rezultat edhe shkarkimet ne mjedis kane natyre diskrete. Te gjitha llojet e shkarkimeve kane regjim periodik. Investitori ne bashkëpunim me ekspertin e mjedisit, do te marrin masa per menaxhimin e integruar te mbetjeve duke minimizuar dhe eliminuar efektet negative ne mjedis.

Mbetjet e ngurta

Gjate zhvillimit te aktivitetit do te gjenerohen mbetje te ngurta te cilat nuk perbejne rrezik per ndotjen e tokes. Natyra e mbetjeve te ngurta eshte eshte e ngjashme me ato urbane dhe perfaqesohet nga mbetjet e letres, plastike, qelqit, etj. qe dalin nga aktiviteti i kantine dhe, mbetjet e ngurta qe dalin aktiviteti i pergjithshem i personelit.

Keto mbetje te ngurta trajtohen sipas parimit te menaxhimit te integruar qe thjesht per ne, do te thote ndarje dhe seleksionim te letres, plasmanit dhe mbetje e tjera qe ne momentin e pare te gjenerimit te tyre ne cdo ambient pune, grumbullimin e tyre ne pika te veçanta brenda ambjeteve te kantine deri ne plotësimin e nje njesie ngarkese per transport.

Theksojme se sistemi i grumbullimit brenda kantine eshte organizuar me kujdes te veçante ne përshatje largimin e tyre nga n/ja dhe destinacionin e tyre përfundimtar. Mbetjet e letres dhe te plastikës transportohen ne pika ricikluese, ndersa mbetjet e ngurta shkojne ne Sheshin e Mbetjeve Urbane ne zonen Spitalle te Durrësit. Largimin e tyre per ne destinacionet përfundimtare ne kemi planifikuar si ze financiar me vete per mbrojtjen e mjedisit dhe e paguajme si sherbim per te tretet.

Mbetjet organike

Sic kemi përshkruar edhe me lart, Kantina Rrashbull, funksionon si pjese teknologjike e plote bashke me Kantine e Sukthit e cila kjo e fundit eshte pajisur me leje mjedisi si instalim me vete. Me kete duam te themi se përpunimi i rrushit dhe vinifikimi, te cilar gjenerojne mbetje organike vegjetale ne sasi te konsiderueshme kryhen pikërisht atje ne Sukth.

Dhe, ne Kantine Rashbull, mbetjet organike jane te natyres se lengjeve te veres nga larjet e vaskave dhe makinerive dhe, mbetjet nga distilimi i veres. Keto lloj mbetjesh kalojne me pare ne procese hollimi, dekantimi dhe precipitimi dhe pastaj kalojne ne kanalizimet e kantine duke përfunduar tek gropa e kanalizimit kryesor ne dalje.

Mbetjet e lengeta

Pra, mbetjet e lengeta jane mbetjet organike qe ndodhen ne ujrata e larjes se vaskave, tankeve dhe linjave te mbushjes produkteve dhe, mbetjet e ujrave te zeza nga aktiviteti jetësor i punonjëseve.

Mbetjet e lengeta nuk kane mbetje te rrezikshme industriale, ato jane te natyres urbane dhe kane rezultuar brenda normave te lejuara te shkarkimeve ne kanalizime. Ato derdhen ne Kolektorin Kryesor te Ujrave te Zones.

Mbetjet e gazta

Mbetjet e gazta rezultojne nga aromat e lengjeve te veres e pijeve te tjera gjate përpunimit dhe mbushjes se tyre dhe nga kaldaja kur ajo fihet ne pune.

Shkarkimet e gazta ne ajer ne vijimesi kane rezultuar brenda normave te lejuara te shkarkimeve ne ajer. Gjate zhvillimit te aktivitetit ne kantine, nuk ka emetime te demshme ne ajer qe shqetesojne banoret e zones per rreth.

Per eliminimin e aromave dhe gazeve nga mjediset e brendshme te punes, cdo repart pune eshte i pajisur me nje sistem efikas ventilim-aspirimi ne përputhje me kushtet teknike te tyre dhe Rregulloren e Sigurimit Teknik.

Ndotja akustike

Aktiviteti ne kantine gjeneron zhurma ne nje mase te caktuar. Ato kane regjim emetimi periodik sepse reparte te veçanta punojne ne kohe te caktuara, pra jo cdo dite.

Duam te nenvizojme se te gjitha linjat dhe makinerite jane instaluar ne salla dhe ambiente me hapësira te bollshme te standardit industrial. Sallat e makinerive, trashesia e mureve dhe ndarjet e reparteve te veçante, jane projektuar ne menyre te tille qe zhurmat amortizohen shume dhe pothuajse nuk degjohen nga njeri repart ne repartin ngjitur.

Niveli i zhurmave brenda dhe jashte ambienteve te punes ka rezultuar ne vijimesi brenda kufijve te lejuar.